



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo  
 Komuna e Gjilanit  
 Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Direktorat za Kulturë, Omladinu i Sport/Department of Culture, Youth and Sport

Në bazë të Nenet 8, Par. 6, të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, vendimi Nr.02-320 për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të OJQ-ve për financim të projekteve/programeve të parqitura në thirrjen publike për mbështetje financiare të individëve dhe OJQ-ve në projektet me aktivitetet kulturore, sportive, dhe rinore në Komunën e Gjilanit të publikuar më 28.02.2024 dhe në bazë të nentit Komisioni në takimin e parë të mbajtur më datë 21.03.2024 miraton:

### RREGULLAT E PUNËS

të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për financim publik të projekteve/programeve sipas thirrjes publike për mbështetje financiare të Individëve dhe OJQ-ve në projektet me aktivitetet kulturore, sportive, dhe rinore në Komunën e Gjilanit

#### Neni 1

#### Qëllimi i miratimit të rregullave

1. Rregullat e punës të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financim të projekteve/programeve sipas thirrjes publike do të rregullojnë mënyrën e kryerjes së detyrave, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Komisionit, vendimmarrjen dhe gëshjicë të tjera në kuadër të kompetencave të komisionit.
2. Komisioni do të punojë duke u bazuar në Rregullat në fuqi, në veçanti në bazë të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

#### Neni 2

#### Kompetencat e komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të vlerësoj çdo aplikim nëse i plotëson ose jo kushtet e përgjithshme procedurale të përcaktuara me thirrjen publike dhe rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Komisioni do të përgatis një raport për të gjitha aplikacionet e shqyrtuara nga komisioni duke listuar

1. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet në aspektin procedural si në vijim:
  - 1.1. Të hapin çdo aplikim të parqitur në kuadër të thirrjes publike dhe të bëjnë regjistrimin e përkatës të aplikacionit, duke përfshirë edhe vendosjen e numrave referues.
  - 1.2. Të analizojnë të gjithë dokumentacionin e parqitur.
  - 1.3. Përcaktojnë nëse aplikimet i kanë përmbushur kushtet e konkursit, duke përfshirë edhe përdorimin e formave të standardizuara dhe plotësimin e tyre nga ana e aplikuesve.
  - 1.4. Të përcaktojnë nëse aplikantët i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara përmes thirrjes publike.
  - 1.5. Nëse është e nevojshme të kërkojnë nga aplikantët për të siguruar informacion/dokumentacion shtesë por që nuk ndikon në përmbajtjen e aplikacionit, si dhe kontrollimin dhe verifikimin e këtij informacioni/dokumentacioni shtesë.
  - 1.6. Të hartojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalin e takimit duke përcaktuar nëse secili prej aplikimeve në mënyrë individuale i plotëson ose jo kushtet e thirrjes publike, mbi bazën e të cilit pastaj Institucioni përkasës do të përgatisë një njoftim me shkrim për aplikantët.
2. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë përmbajtjen e aplikacioneve si në vijim:

### **Detyrat e anëtarëve të komisionit**

#### **Neni 3**

3. Në fazën e dytë të vlerësimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes të gjitha aplikimeve në kuadër të thirrjes publike të cilat i plotësojnë kriteret formale për vlerësim përmbajtësor.
4. Komisioni vendos për ndarjen e detyrave brenda komisionit, dhe përcakton nëse secili nga anëtarët do të vlerësojnë secilin aplikacion apo do të bëhet ndarja e përgjegjësisve.
5. Edhe në rastet kur brenda komisionit ndahen detyrat, përgjegjësia e komisionit dhe vendimmartja është kolektive.
6. Komisioni do të sigurojë që secili nga anëtarët të ketë ndarje dhe ngarkesë proporcionale me detyra në kuadër të komisionit.
7. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e komisionit paraqet ndonjë konflikt interesi, atëherë komisioni duhet të shqyrtoj rastin e tillë dhe të kërkojë udhëheqësit të institucionit zëvendësimin e tij. Në këto raste, detyra në zëvendësimin e anëtarit në konflikt interesi, anëtarit rezervë do ta zëvendësojë atë.
8. Tek vlerësimi i përmbajtjes së aplikacioneve, komisioni ka për detyrë të bëjë kalkulimin e pikëve përfundimtare për secilin nga aplikacionet e që do të llogaritet duke marrë për bazë pikët e secilit nga anëtarët e komisionit të mbledhura dhe të pjesëtara për të për numrin e anëtarëve të komisionit për të nxjerrë pikët mesatare që do të marrë secili aplikacion.
9. Bazuar në vlerësimet e secilit projekt/program, komisioni për vlerësimin e aplikacioneve do të bëjë listën përfundimtare të projekteve/programeve të cilat do të financohen përmes fondëve publike.
10. Komisioni është përgjegjës për të bërë listën përfundimtare të përfundimtare të projekteve të cilat do të mbështeten përmes fondëve publike dhe të njëjten do e përcjellë për aprovim përfundimtar tek udhëheqësi/zzyrtar më i lartë administrativ përgjegjës për fondet publike në kuadër të institucionit.

1. Çdo anëtar i Komisionit vlerësohet në fillim të nënshkrimit dhe deklarimit të paanësisë dhe konfidencialitetit. Me nënshkrimin e Deklaratës, anëtarët e Komisionit konfirmojnë se deklaratat e tyre në komision do trajtohen në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me parimet e shantazit të interesave. Po ashtu, ata pranojnë se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha aplikacionet, duke i vlerësuar në përputhje me rregullat në fuqi.
2. Secili anëtar i komisionit që ka informacion se ndonjëri nga anëtarët mund të ketë konflikt të interesit, duhet që ta informojë komisionin menjëherë.
3. Anëtarët e komisionit vlerësohen gjatë dhe pas përfundimit të punës së komisionit nuk kanë të drejtë të nxjerrin informacion në publik apo të informojnë ndonjërin prej aplikantëve mbi përmbajtjen e diskutimeve dhe vendimeve të marra përkatësi me aplikimet individuale, dhe nuk guxojnë të japin asnjë lloj informacioni i cili është i karakterit të brendshëm.

### **Shmangia e konfliktit të interesit dhe mbajtja e konfidencialitetit**

#### **Neni 5**

1. Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve sipas thirrjes publike për mbështetje financiare të Individëve dhe OJQ-ve në projektet me aktivitete kulturore, sportive, dhe rinore në Komunën e Gjilanit ka anëtarë dhe kryesuesi i komisionit.
2. Kryesuesi e koordinon punën e Komisionit, duke përfshirë edhe koordinimin e qëndrimeve për përgatitjen e raportit përfundimtar të Komisionit vlerësues.
3. Në rast të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e komisionit vlerësues, vendim për aprovimin e dorëheqjes së tij e marrë zyrtarisht nga kryesuesi i cili ka themeluar komisionin. Deri në aprovimin formal të dorëheqjes, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë në punën e rregullt të komisionit, përveç rasteve të konfliktit të interesit.
4. Në rast të dorëheqjes të ndonjërit nga anëtarët e komisionit, kryesuesi do të ftojë anëtarin rezervë për të marrë pjesë në vlerësim.

### **Përbërja e komisionit dhe detyrat e anëtarëve**

#### **Neni 4**

- 2.1. Të informohet me tekstin e thirrjes publike dhe të nënshkrimit dhe deklarimit të paanësisë dhe konfidencialitetit.
- 2.2. Të shqyrtojë dhe vlerësojë përmbajtjen e projekteve dhe programeve të OJQ-ve aplikuese të cilat i kanë plotësuar kriteret procedurale. Vlerësimi duhet të bëhet sipas pyetjeve dhe formave të parapara me rregullat juridike në fuqi.
- 2.3. Të bëjë vlerësim të paanshëm, objektiv dhe pa ndikim nga subjektet tjera, duke shpjeguar me shkrim vlerësimin e tij, dhe duke iu referuar në shpjegimet e tij dokumentacionit të OJQ-së aplikuese, madje edhe duke cituar ato, dhe duke treguar pse pikërisht ka bërë atë poentim(vlerësim).
- 2.4. Të vlerësojë koston e projektit për të formuar buxhetin e nevojshëm për impementimin e tij.
- 2.5. Të identifikojë dhe vlerësojë përparësitë dhe mangësitë e çdo aplikacioni të vlerësuar.
- 2.6. Të rekomandojë sigurimin e dokumentacionit shpesh nëse e shpreh në nevojshme.

4. Emrat e anëtarëve të komisionit do të bëhen publik vetëm kur të publikohen rezultatet e thirrjes.

#### Neni 6

#### Mbështetja teknike për komisionin vlerësues

Përkrahja administrative dhe teknike për të gjitha aktivitetet e komisionit që ndërlidhen me thirrjen publike duhet të sigurohet nga institucioni/njësia që ka hapur thirrjen publike.

#### Neni 7 Hyrja në fuqi

Rregullat e punës së komisionit vlerësues janë miratuar në takimin/seancën e mbajtur më: 21.03.2024.

Anëtarët e komisionit

Alban Shahiqi

Armend Misini

Nderim Brestovci

Herolinda Bajrami

Xhemile Musliu

Anëtarë Rezervë  
Erson Zyberi

